KREU IX
PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 45

Mënyra e zgjedhjes

Këshilli bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 46

Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak

1. Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë:
   - Bashkitë deri në 20 000 banorë 15 anëtarë;
   - Bashkitë nga 20 001 deri në 50 000 banorë 21 anëtarë;
   - Bashkitë nga 50 001 deri në 100 000 banorë 31 anëtarë;
   - Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë 41 anëtarë;
   - Bashkitë nga 200 001 deri në 400 000 banorë 51 anëtarë;
   - Bashkitë mbi 400 000 banorë 61 anëtarë.
2. Në zbatim të këtij neni, prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet vendore.

Neni 47

Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit

1. Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:
a) funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë;
b) funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak;
c) funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;
ç) funksionin e deputetit;
d) funksionin e ministrit.
2. Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak.
3. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrri e vjehrra me nusen e dhëndrin.

Neni 48

Mbledhja e parë e këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga data e shpalljes së rezultatit nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor.
2. Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i këshillit bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti.
3. Në rast se asnjë nga subjektet e sipër-përmendura nuk e ushtron këtë të drejtë, brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, atëherë këshilli mblidhet vetë brenda 10 ditëve.
4. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij, të shpallur nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Nëse nuk mblidhen më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të këshillit, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret çdo tri ditë, por jo më shumë se tri herë. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrjeje nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, këshilli konsiderohet i shpërndarë.
5. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë.
6. Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak:
a) zgjidhet komisioni i mandateve;
b) miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit;
c) këshilltarët bëjnë betimin;

ç) zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit;
d) zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen me mandatin e përfaqësimit.
7. Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 49

Mandati i këshilltarit

1. Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak.
2. Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.
3. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.
4. Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit kur:
a) ndryshon vendbanimin jashtë territorit të bashkisë ku është zgjedhur;
b) jep dorëheqjen;
c) krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji;
ç) mandati, nga ana e tij, është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
d) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykate;
dh) vdes;
e) nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;
ë) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë;
f) këshilli shpërndahet nga organi kompetent.
5. Mbarimi i mandatit para kohe deklarohet me vendim të këshillit bashkiak, me propozim të komisionit të mandateve.

Neni 50

Betimi

1. Pas verifikimit të mandateve nga komisioni përkatës, këshilltarët bëjnë këtë betim para këshillit:
"Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë (*emri i bashkisë përkatëse*) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre".
2. Këshilltari që mungon me arsye në bërjen e betimit betohet në mbledhjen më të parë që merr pjesë. Këshilltari, që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati.

Neni 51

Të drejtat e këshilltarit

1. Këshilltari kryen funksionin me shpërblim mujor të barabartë me 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të bashkisë përkatëse.
2. Punëdhënësi detyrohet të lejojë anëtarin e këshillit bashkiak të shkëputet nga puna për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, komisioneve të tij apo aktivitete të organizuara prej këshillit bashkiak.
3. Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë, nga kryetari i bashkisë përkatëse, çdo dokumentacion i lidhur me bashkinë.
4. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

Neni 52

Kushtet e pengesës ligjore, vete deklarimi dhe p e rjashtimi

1. Anetari i këshillit bashkiak nuk perfshihet ne nje procedure shqyrtimi dhe vendimmarrese ne rastet kur:
a) ka nje interes personal te drejtperdrejte ose jo te drejtperdrejte ne vendimmarrjen ne shqyrtim;
b) bashkeshorti, bashkejetuesi ose te afermit e tij deri ne shkalle te dyte kane nje interes te drejtperdrejte ose jo te drejtperdrejte ne vendim-marrjen ne shqyrtim;
c) ai ose edhe personat e parashikuar ne shkronjen "b", te kesaj pike, kane nje interes te drejtperdrejte ose jo te drejtperdrejte ne nje ceshtje objektivisht te njejte dhe me te njejtat rrethana ligjore me ceshtjen ne shqyrtim;
c) ai ka marre pjese si ekspert, keshilltar, perfaqesues ose avokat privat ne ceshtjen ne shqyrtim;
d) personat e permendur ne shkronjen "b", te kesaj pike, kane marre pjese si eksperte perfaqesues, keshilltare apo avokate ne ceshtjen ne shqyrtim;
dh) ai ose personat e permendur ne shkronjen "b", te kesaj pike, jane debitore ose kreditore te paleve te interesuara ne çështjen ne shqyrtim;
e) ai ose personat e permendur ne shkronjen "b", te kesaj pike, kane marre dhurata nga palet perpara ose pas fillimit te procedures së shqyrtimit;
ë) ai ose personat e permendur ne shkronjen "b", te kesaj pike, kane marredhenie te tilla, te cilat vleresohen, sipas rrethanave konkrete, se do te perbenin arsye serioze per njeanshmeri me palet ne proceduren ne shqyrtim;
f) ne cdo rast parashikohet nga legjislacioni ne fuqi;
g) ai ose personat e permendur ne shkronjen "b", te kesaj pike, jane perfshire ne cdo lloj menyre ne negocime te mundshme per punesim ne te ardhmen të tij apo të personave te permendur ne shkronjen "b", te kesaj pike, gjate ushtrimit te funksionit apo në negocime per cdo lloj forme tjeter marredheniesh me interes privat, pas lenies se detyres, te kryera nga ai gjate ushtrimit te detyres.
2. Nese anetari i këshillit bashkiak veren nje nga pengesat e parashikuara ne pikën 1, të këtij neni, ai njofton menjehere me shkrim kryetarin e këshillit bashkiak.
3. Persona të tretë mund te kerkojne perjashtimin e pjesemarrjes se një anetari te këshillit bashkiak nga nje procedure, deri ne kohen e marrjes se vendimit, duke parashtruar arsyet per te cilat kerkohet perjashtimi nga shqyrtimi dhe vendimmarrja. Kerkesa behet me shkrim, i drejtohet kryetarit të këshillit bashkiak dhe permban te gjitha provat e mundshme ne te cilat ajo mbeshtetet.
4. Kryetari i këshillit bashkiak, i njoftuar sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, i propozon këshillit bashkiak perjashtimin ose konfirmimin e anëtarit të këshillit bashkiak nga/në procedura vendim-marrëse.

Neni 53

Funksionimi i këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e konstituimit, sipas nenit 48, të këtij ligji, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.
2. Mbledhjet e radhës së këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.
3. Këshilli mblidhet në çdo rast:
a) me kërkesën e kryetarit të bashkisë;
b) me kërkesën me shkrim të jo më pak se 1/3 së anëtarëve të tij;
c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
4. Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.
5. Rendi i ditës miratohet nga këshilli.

6. Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm bashkiak ushtron kompetenca të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.
7. Mbledhja e këshillit bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 55 të këtij ligji.
8. Mbledhjet e këshillit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe e vërtetimit të tij përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:
a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;
ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
gj)vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;
k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;
l) vendos për simbolet e bashkisë;
ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;
m) jep tituj nderi dhe stimuj;
n)vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.

Neni 55

Votimi

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.

2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.
3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gj", "i" dhe "j", të nenit 54, të këtij ligji.
4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën "e", të nenit 54, të këtij ligji.
5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.
6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 56

Kryetari i këshillit bashkiak

1. Kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit bashkiak zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet me shkrim nga të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit.
2. Kryetari i këshillit kryen këto detyra:
a) thërret mbledhjen e këshillit, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji;
b) drejton mbledhjet e këshillit, në përputhje me rregulloren e tij;
c) nënshkruan aktet që nxjerr këshilli;
ç) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në rregulloren e këshillit.
3. Në mungesë të kryetarit të këshillit, detyrat e tij i kryen zëvendëskryetari, sipas përcaktimit në rregulloren e brendshme të këshillit.

Neni 57

Sekretari i këshillit bashkiak

1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.
2. Sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës për:
a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, sipas rendit të ditës;
c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
ç) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve e të akteve të nxjerra nga këshilli bashkiak;
d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.
3. Sekretari i këshillit bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

Neni 58

Shpërndarja e parakohshme e këshillit bashkiak

1. Kur këshilli bashkiak nuk mblidhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore nga mbledhja e fundit e tij, prefekti thërret mbledhjen e tij, jo më vonë se 20 ditë nga ky afat. Nëse edhe pas thirrjes së prefektit këshilli bashkiak nuk mblidhet, atëherë ai shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Këshilli bashkiak shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave edhe kur:
a) nuk miratohet buxheti brenda afatit të përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Në këtë rast prefekti i kërkon kryetarit të bashkisë të thërrasë mbledhjen e këshillit bashkiak, e cila

duhet të mbahet jo më vonë se 10 ditë nga data e mbarimit të këtij afati. Në rast se edhe në këtë rast këshilli bashkiak nuk arrin të miratojë buxhetin, vendoset shpërndarja e tij para kohe;
b) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve.
3. Këshilli bashkiak shpërndahet edhe kur bëhet riorganizim me ndryshim kufijsh, sipas nenit 93 të këtij ligji.
4. Në rast të lënies në fuqi të vendimit të shpërndarjes nga organi kompetent, në bashkinë përkatëse organizohen zgjedhjet për këshillin, në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
5. Deri në konstituimin e këshillit të ri, funksionet dhe kompetencat e këshillit, për aq sa është e mundur, kryhen nga kryetari i bashkisë.